



Titulli i projektit

Asistencë për inventarizim dhe konsolidimin e asetëve dhe financave të SHAUK për territorin e ZF Malësi e Madhe

Tipi i projektit

Quick start, Manaxhim i Zonës Funksionale

Vendndodhja e projektit

Qendra e ZF

Buxheti i paravlerësuar

45,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/ëve

Njësia e re administrative, përfaqësuese e Zonës së re Funksionale, do të përballet menjëherë me nevojën për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për banorët e saj. Drejtuesve të Zonës Funksionale do t'u duhet të themelojnë dhe të licencojnë një ndërmarrje që të marrë në dorë administrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e largimin e ujrave të ndotura në të gjithë territorin e Zonës Funksionale.

Një njohje më e thellë e situatës së ofrimit të këtyre shërbimeve është e nevojshme, pasi shumë të dhëna mungojnë, ose janë mbi bazë hamendësimi.

Në kuadër të organizimit dhe funksionimit të një ndërmarrje të re, detyra të tjera do të merren në konsideratë menjëherë, përfshirë, por jo duke u limituar në:

- Hartimin e Planit të Investimeve Kapitale, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, në përputhje me burimet aktuale të financimit, si dhe me Masterplanin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve të Shqipërisë,
- Llogaritjen e kostove dhe tarifave,
- Vendosijen e një sistemi faturimi dhe arkëtimi për të ardhurat

Qëllimi/et specifike të projektit

Projekti ka si objektiv identifikimin e bazës së të dhënave për ndërmarrjen e re të ujësjellësit dhe kanalizimeve për Zonën Funksionale Malësi e Madhe, si dhe matjen e standardeve të shërbimit të furnizimit me ujë dhe atij të largimit të ujërave të ndotura.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- Rregjistër i burimeve ujore, tipi, sasia e ujit, vendndodhja,
- Rregjistër i rrjeteve të tubacioneve dhe e standardit të tyre,
- Rregjistër i popullsisë në fshatra/qytete që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë nëpërmjet sistemeve të centralizuara,
- Rregjistër i sistemeve të centralizuara (me vetërrjedhje dhe / ose me ngritje mekanike),
- Listë e konsoliduar e personelit të angazhuar sipas kategorisë së punës,
- Tregues të matshëm të shërbimit, përfshirë kohëzgjatjen e furnizimit me ujë për çdo sistem,
- Identifikimin e popullsisë në fshatra/qytete që mbulohen me shërbimin e furnizimit me ujë direkt nga burimet natyrore dhe identifikimi i këtyre burimeve,
- Hartë e GIS e populluar me të gjithë informacionin e mësipërm.



Aktivitetet e projektit

- Identifikimi i burimeve ujore, tipi, sasia e ujit, vendndodhja,
- Identifikimi i rrjeteve të tubacioneve dhe e standardit të tyre,
- Identifikimi i popullsisë në fshatra/qytet që mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë nëpërmjet sistemeve të centralizuara,
- Identifikimi i sistemeve të centralizuara (me vetërrjedhje dhe / ose me ngritje mekanike),
- Identifikimi i personelit të angazhuar sipas kategorisë së punës,
- Matja e sasisë së shërbimit, përfshirë kohëzgjatjen e furnizimit me ujë për çdo sistem,
- Identifikimin e popullsisë në fshatra/qytet që mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë direkt nga burimet natyrore dhe identifikimin e këtyre burimeve,
- Hedhja e të dhënave në GIS.

Maturimi i projektit

Aktualisht nuk ekzistojnë të dhëna të sakta për asnjë nga aspektet e funksionimit të Shoqërisë Aksionere Ujësjellës-Kanalizime Malësi e Madhe. Në raportet e vlerësimit të performancës të Entit Rregullator të Ujit komentohet për luhatjet e vazhdueshme në dhënat e raportuara nga SHAUK Malësi e Madhe. Ekzistojnë disa të dhëna bazë për një pjesë të territorit, të cilat duhen integruar me pjesë të territorit që nuk kanë qenë pjesë e kësaj SHAUK dhe i kanë administruar në mënyrë individuale burimet, sistemet dhe shërbimet në fjalë.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Bashkia Malësi e Madhe
DLDP
MTI

Kostot e projektit

Kosto e vlerësuar e një asistence të tillë për situatën e të dhënave në SHAUK Malësi e Madhe është 45,000 Euro.